



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 75

Tiranë – E mërkurë, 12 prill 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 26/2017 datë 16.3.2017	Për produktet kozmetike..... 4703
Ligj nr. 27/2017 datë 23.3.2017	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar..... 4712
Ligj nr. 28/2017 datë 23.3.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar..... 4713
Ligj nr. 29/2017 datë 23.3.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” ..... 4716
Ligj nr. 30/2017 datë 23.3.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve” ..... 4724
Ligj nr. 31/2017 datë 23.3.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II” ..... 4726



**LIGJ**  
**Nr. 26/2017**

**PËR PRODUKTET KOZMETIKE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe garantimin e cilësisë së produkteve kozmetike të bëra të disponueshme në treg, duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushë çdo produkt kozmetik.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet kozmetike, të prodhuara në mënyrë industriale, të vendosura në tregun e Republikës së Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet për produktet kozmetike, sipas përkufizimit në këtë ligj, duke mos përfshirë substanca ose përzierje të destinuar për administrim nga goja, inhalim, injektim ose implantim brenda trupit të njeriut.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Produkt kozmetik” është çdo substancë ose përzierje, e destinuar për t’u vendosur në kontakt me pjesët e jashtme të trupit të njeriut (epidermë, flokë, thonj, buzë dhe organet e jashtme gjentile)

ose dhëmbë, membranat mukozë të kavitetit oral, me qëllim të vetëm ose kryesisht pastrimin e tyre, parfumosjen, ndryshimin e pamjes, mbrojtjen dhe mbajtjen e tyre në kushte të mira ose korrigjimin e erës së trupit.

2. “Substancë” është elementi kimik dhe përbërësit e tij në gjendje natyrore ose të përfutur nëpërmjet procesit të prodhimit, duke përfshirë çdo shtesë të mundshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj dhe çdo papastërti të ardhur si pasojë e procesit të përdorur, me përjashtim të çdo tretësi, i cili mund të ndahet pa ndikuar në qëndrueshmërinë e substancës ose në ndryshimin e përbërjes së saj.

3. “Përzierje” është tretësira e përbërë nga dy ose më tepër substanca.

4. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili prodhon një produkt kozmetik ose ka një produkt të tillë të disenjuar ose të prodhuar dhe tregon këtë produkt kozmetik sipas emrit ose markës së tij të regjistruar.

5. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik në rrjetin e furnizimit, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i ndryshëm nga prodhuesi ose importuesi, i cili bën të disponueshëm në treg produktin kozmetik.

6. “Përdorues i fundit” është konsumatori ose profesionisti që përdor produktin kozmetik.

7. “Bërje e disponueshme në treg” është çdo furnizim i një produkti kozmetik i destinuar për t’u shpërndarë, konsumuar ose përdorur në treg gjatë një veprimtarie tregtare, kundrejt pagesës ose falas.

8. “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit në treg.

9. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar një produkt kozmetik nga një vend tjetër.

10. “Standard i harmonizuar shqiptar” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në legjislacionin shqiptar për standardizimin.

11. “Nanomaterial” është materiali i patretshëm ose biopersistent, i prodhuar qëllimisht me një ose disa përmasa të jashtme apo një strukturë të brendshme të shkallës 1 – 100 nm.

12. “Konservues” janë substancat, të cilat, veçanërisht ose kryesisht, kanë për qëllim frenimin e zhvillimit të mikroorganizmave në produktin kozmetik.

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 1223/2009 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 30 nëntor 2009, “Për produktet kozmetike”, të ndryshuar. CELEX 32009R1223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L. nr. 342, datë 22.12.2009, faqe 59-209.



13. “Ngjyrues” janë substancat, të cilat, veçanërisht ose kryesisht, përdoren për ngjyrosjen e produktit kozmetik, të trupit në tërësi ose pjesëve të tij, nëpërmjet përthithjes ose reflektimit të dritës së dukshme. Prekursorët e ngjyruesve oksidues të flokëve konsiderohen gjithashtu ngjyrues.

14. “Filtër UV” janë substancat, të cilat, veçanërisht ose kryesisht, përdoren për të mbrojtur lëkurën nga disa rrezatime UV nëpërmjet përthithjes, reflektimit ose shpërndarjes së rrezatimit UV.

15. “Efekt i padëshirueshëm” është efekti i dëmshëm për shëndetin e njeriut, që i atribuohet përdorimit në kushte normale ose të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme të produktit kozmetik.

16. “Efekt i padëshirueshëm serioz” është efekti i padëshirueshëm, që rezulton në pamundësi funksionale të përkohshme ose të përhershme, paaftësi, trajtim në spital, anomali të trashëguara ose në një rrezik të menjëhershëm për jetën apo në vdekje.

17. “Ndalim i tregtimit” është çdo masë e marrë, me qëllim parandalimin e bërjes së disponueshme në treg të produktit kozmetik në rrejetin e shpërndarjes.

18. “Kthim i produktit” është çdo masë e marrë për kthimin mbrapsht të produktit kozmetik që është bërë ndërkohë i disponueshëm te përdoruesi i fundit.

19. “Formulim kuadër” është formulimi që liston kategorinë ose funksionin e përbërësve dhe përqendrimin maksimal të tyre në produktin kozmetik ose që jep informacionin përkatës sasior dhe cilësor, kur produkti kozmetik nuk mbulohet tërësisht ose pjesërisht nga ky formulim.

20. “Përbërës” është çdo substancë ose përzjerje, qëllimisht e përdorur gjatë procesit të prodhimit të produktit kozmetik, e ndryshme nga papastërtitë në substancat e para të përdorura dhe materialet teknike ndihmëse të përdorura në përzjerje, por jo të pranishme në produktin përfundimtar.

21. “Ministria” është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

## KREU II

### SIGURIA E PRODUKTEVE KOZMETIKE, PRODHUESI, PERSONI PËRGJEGJËS

#### Neni 4

#### **Parime të përgjithshme të sigurisë së produkteve kozmetike**

1. Çdo produkt kozmetik, i bërë i disponueshëm në treg, duhet të jetë i sigurt për shëndetin e njerëzve, nëse përdoret në kushte normale apo të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh veçanërisht elementet e mëposhtme:

a) paraqitjen e jashtme, që, në çdo rast, duhet të jetë qartësisht e dallueshme nga paraqitja e jashtme e produkteve ushqimore;

b) etiketimin;

c) udhëzimet për përdorim;

ç) çdo tregues apo informacion tjetër të siguruar nga personi përgjegjës, përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

2. Përcaktimet e bëra në këtë nen nuk i përjashtojnë personat përgjegjës për vendosjen në treg të produkteve kozmetike nga rregullat e tjera të vendosura në këtë ligj dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

#### Neni 5

#### **Prodhuesi i produkteve kozmetike**

1. Prodhuesi vendas i produkteve kozmetike është personi fizik ose juridik, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për këtë qëllim.

2. Prodhuesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e këtij ligji, parimet dhe udhëzimet e praktikës së mirë të prodhimit të produkteve kozmetike dhe legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

3. Prodhimi i produkteve kozmetike prezumohet në përputhshmëri me praktikën e mirë të prodhimit kur procesi i prodhimit kryhet sipas standardeve përkatëse të harmonizuara shqiptare, lista referencë e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Parimet dhe udhëzimet e praktikës së mirë të prodhimit të produkteve kozmetike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë prodhuesit vendas.



## Neni 6

**Personi përgjegjës**

1. Lejohet vendosja në treg vetëm për produktet kozmetike, për të cilat është përcaktuar një person përgjegjës, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili siguron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj.

2. Për çdo produkt kozmetik të vendosur në treg, personi përgjegjës duhet të sigurojë përmbushjen e të gjitha kriterëve të parashikuara në këtë ligj.

3. Person përgjegjës është personi fizik ose juridik, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili, në varësi të rastit, është:

a) prodhuesi vendas, për çdo produkt kozmetik të prodhuar prej tij;

b) importuesi, për çdo produkt kozmetik të importuar dhe të vendosur në tregun vendas prej tij;

c) shpërndarësi, për çdo produkt kozmetik të vendosur në tregun vendas nën emrin apo markën tregtare apo kur modifikon një produkt kozmetik që tashmë është vendosur në treg në atë mënyrë që mund të ndikojë në përputhshmërinë e produktit me kërkesat e këtij ligji. Përkthimi i informacionit, në lidhje me produktin kozmetik, që është vendosur në treg, nuk konsiderohet modifikim i produktit në atë mënyrë/masë që mund të ndikojë në përputhshmërinë e produktit me kërkesat e këtij ligji.

## Neni 7

**Detyrimet e personit përgjegjës**

1. Personi përgjegjës, i cili vlerëson se një produkt kozmetik, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ai në mënyrë të menjëhershme merr masat e nevojshme korrigjuese për të siguruar përputhshmërinë e produktit me standardet e vendosjes në treg, për ta ndaluar apo tërhequr atë, në varësi të situatës.

2. Në rast se produkti kozmetik paraqet rrezik për shëndetin publik, personi përgjegjës, i cili zotëron dosjen e informacionit të produktit kozmetik, ku në mënyrë të veçantë specifikohen papërputhshmëritë dhe masat korrigjuese, që mund të merren, njofton në mënyrë të menjëhershme ministrinë.

3. Personi përgjegjës bashkëpunon me ministrinë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, lidhur

me çdo veprim për eliminimin e rrezikshmërisë së paraqitur nga produkti kozmetik, të cilin e ka bërë të disponueshëm në treg.

4. Personi përgjegjës, pas një kërkesë të ministrisë, ofron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar përputhshmërinë e produktit në një gjuhë të kuptueshme nga kjo ministri.

## Neni 8

**Detyrimet e shpërndarësit**

1. Para bërjes së disponueshme në treg të produktit kozmetik, shpërndarësi verifikon që:

a) informacioni mbi etiketën e produktit është në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

b) janë përmbushur kërkesat mbi gjuhën e përdorur, të parashikuara në këtë ligj;

c) nuk është tejkaluar data e vlefshmërisë minimale të kërkuar.

2. Shpërndarësi, i cili vlerëson se:

a) një produkt kozmetik nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, në mënyrë të menjëhershme merr masat e nevojshme korrigjuese për të siguruar përputhshmërinë e këtij produkti me kërkesat e këtij ligji para bërjes së disponueshme në treg;

b) një produkt kozmetik, të cilin e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, në mënyrë të menjëhershme merr masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë këtë produkt në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ndalon tregtimin e tij apo e tërheq atë nga tregu, në varësi të situatës.

3. Në rast se produkti kozmetik paraqet rrezik për shëndetin publik, shpërndarësi, në mënyrë të menjëhershme, njofton personin përgjegjës dhe ministrinë, duke dhënë detaje në mënyrë të veçantë për mospërputhshmërinë dhe masat korrigjuese të marra.

4. Shpërndarësi garanton se, ndërkohë që produkti është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e ruajtjes apo transportit nuk cenojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

5. Shpërndarësi bashkëpunon me ministrinë, me kërkesë të kësaj të fundit, lidhur me çdo veprim për eliminimin e rrezikshmërisë së paraqitur nga produkti kozmetik, që ai e ka bërë të disponueshëm në treg.



6. Shpërndarësi, pas një kërkesë të ministrisë, ofron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin për të vërtetuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat e renditura në pikën 1, të këtij neni, në një gjuhë të kuptueshme nga kjo ministri.

#### Neni 9

##### Identifikimi brenda rrjetit të shpërndarjes

1. Bazuar në kërkesën e ministrisë:

- a) personi përgjegjës identifikon shpërndarësit, të cilët i furnizon me produkte kozmetike;
- b) shpërndarësi identifikon personat prej të cilëve është furnizuar (një shpërndarës tjetër ose person përgjegjës) dhe personat të cilët i ka furnizuar me produktin kozmetik (shpërndarësit).

2. Këto detyrime zbatohen për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data në të cilën produktit kozmetik është bërë i disponueshëm për shpërndarësin.

#### KREU III

#### VLERËSIMI I SIGURISË, DOSJA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT KOZMETIK DHE PROCEDURA E NJOFTIMIT

#### Neni 10

##### Vlerësimi i sigurisë

1. Me qëllim demonstrimin që produkti kozmetik është në përputhje me parashikimet e nenit 4, të këtij ligji, personi përgjegjës, para se të vendosë në treg një produkt kozmetik, duhet të sigurojë që ky produkt i është nënshtruar një vlerësimi sigurie në bazë të informacionit përkatës. Formulari dhe kërkesat e raportit mbi sigurinë e produktit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Personi përgjegjës duhet të sigurojë që:

- a) qëllimi i përdorimit të produktit kozmetik dhe ekspozimi sistematik ndaj përbërësve të veçantë në formulën përfundimtare janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të sigurisë;
- b) në vlerësimin e sigurisë është përdorur qasja e duhur për shikimin e të dhënave nga të gjitha burimet e mundshme;
- c) raporti i sigurisë së produktit kozmetik përditësohet duke pasur parasysh informacionet shtesë të duhura, pasi produkti kozmetik është vendosur në treg.

3. Vlerësimi i sigurisë së produktit kozmetik kryhet nga personi që zotëron diplomë ose dëshmi të tjera kualifikimesh, të marra pas përfundimit të një kursi universitar të studimeve teorike dhe praktike në degët farmaci, toksikologji, mjekësi apo disiplina të tjera të ngjashme.

#### Neni 11

##### Dosja e informacionit për produktin

1. Kur një produkt kozmetik vendoset në treg, personi përgjegjës mban një dosje informacioni për produktin, e cila ruhet për një periudhë 10-vjeçare nga data e vendosjes në treg të sasisë së fundit të produktit kozmetik.

2. Dosja e informacionit për produktin përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) një përshkrim të produktit kozmetik;
- b) raportin e sigurisë së produktit, sikurse parashikohet në nenin 10 të këtij ligji;
- c) një përshkrim të metodës së prodhimit dhe një deklaratë përputhshmërie me praktikën e mirë të prodhimit;
- ç) dëshmi të efektit të pretenduar të produktit kozmetik;
- d) të dhëna mbi testimet në kafshë, të kryera nga prodhuesi, persona të ngarkuar prej tij ose furnizuesit, lidhur me vlerësimin e sigurisë së produktit kozmetik dhe përbërësve të tij, përfshirë çdo testim të kafshët, të kryer për të përmbushur kërkesat legjislative ose rregullatore të vendeve të treta.

3. Informacioni që përmban dosja e produktit i vihet në dispozicion ministrisë në gjuhën shqip ose anglisht.

#### Neni 12

##### Njoftimi

1. Para vendosjes në treg të produktit kozmetik, personi përgjegjës duhet t'i njoftojë në formë elektronike ministrisë informacionin e mëposhtëm:

- a) kategorinë e produktit kozmetik, emrin /emrat e tij, duke bërë të mundur identifikimin specifik të tij;
- b) emrin dhe adresën e personit përgjegjës, nëpërmjet të cilit dosja e informacionit të produktit është lehtësisht e arritshme;
- c) vendin e origjinës në rast importi;
- ç) praninë e substancave në formën e nanomaterialeve, si dhe:



i) identifikimin e tyre, përfshirë emërtimin kimik (IUPAC) dhe përshkruesit e tjerë të specifikuar në rregulloren mbi përdorimin e nanomaterialeve në produktet kozmetike, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë;

ii) kushtet e ekspozimit të mundshëm;

d) emrin dhe përcaktimin, sipas klasifikimit përkatës për substancat e klasifikuara si kancerogjene, mutagjenike ose toksike për riprodhimin;

dh) formulimin kuadër, i cili, në raste vështirësish, lehtëson trajtimin e menjëhershëm dhe të përshtatshëm mjekësor.

2. Kur produkti kozmetik vendoset në treg, personi përgjegjës njofton ministrinë mbi etiketimin origjinal dhe dorëzon një fotografi të paketimit përkatës qartësisht të lexueshëm.

3. Personi përgjegjës apo shpërndarësi, në rast ndryshimesh të informacionit të listuar në këtë nen, është i detyruar të përditësojë njoftimin e depozituar te ministria.

Neni 13

#### **Kufizime për substanca të caktuara të produkteve kozmetike**

1. Nuk lejohet vendosja në treg e produkteve kozmetike, që përmbajnë substancat e ndaluara, sipas përcaktimit të bërë në listën për substancat e ndaluara të produkteve kozmetike.

2. Lista e substancave të ndaluara ose me përdorim të kufizuar për produktet kozmetike miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

#### **Nanomaterialet**

1. Për çdo produkt kozmetik, që përmban nanomateriale, duhet të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

2. Dispozitat e këtij neni nuk aplikohen për nanometarialet e përdorura si substancë ngjyruese, filtra UV ose substancë konservuese, përveçse kur specifikohet shprehimisht.

3. Personi përgjegjës informon elektronikisht ministrinë për produktet kozmetike që përmbajnë nanomateriale, gjashtë muaj përpara se ato të vendosen në treg.

4. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk zbatohen për produktet kozmetike që përmbajnë nanomateriale, të cilat janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në “listën e substancave që nuk lejohen të jenë në

përbërjen e produkteve kozmetike, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara”.

5. Në informacionin e njoftuar elektronikisht nga personi përgjegjës apo personi i autorizuar prej tij përfshihen:

a) identifikimi i nanomaterialit, duke përcaktuar emërtimin e tij kimik (IUPAC) dhe duke dhënë përshkrime të tjera sikurse specifikohet në listat e miratuara në zbatim të nenit 15 të këtij ligji;

b) specifikimi i nanomaterialit, duke përcaktuar madhësinë e grimcave dhe vetitë fiziko-kimike;

c) një vlerësim i sasisë së nanomaterialeve, që përmbahen në produktin kozmetik, që do të vendoset në treg çdo vit kalendarik;

ç) profili toksikologjik i nanomaterialit;

d) të dhëna mbi sigurinë e nanomaterialit që lidhen me kategorinë e produktit kozmetik, sikurse përdoret në produkte të tilla;

dh) kushtet e ekspozimit të mundshëm.

Neni 15

#### **Gjurmët e substancave të ndaluara**

Prania jo e qëllimshme e sasive të vogla të substancave të ndaluara, ndarja nga papastërtitë e përbërësve sintetikë ose natyralë, procesi i prodhimit, ruajtjes, heqjes nga paketimi, i cili është teknikisht i pashmangshëm në praktikën e mirë të prodhimit, lejohen vetëm nëse kjo prani është në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

KREU IV

#### **INFORMIMI I KONSUMATORIT**

Neni 16

#### **Etiketimi**

1. Produktet kozmetike bëhen të disponueshme në treg, vetëm nëse ambalazhi primar dhe paketimi i tyre përmbajnë informacionin e mëposhtëm, në shkrim, i cili nuk fshihet lehtë dhe është qartësisht i shkruar dhe i lexueshëm:

a) emrin e regjistruar dhe adresën e personit përgjegjës. Informacioni mund të jepet në formë të shkurtuar, vetëm nëse shkurtimi bën të mundur identifikimin e personit dhe adresës së tij. Në rast të disa adresave, specifikohet adresa e personit përgjegjës, i cili mundëson leximin e dosjes së informacionit të produktit;

b) vendin e origjinës për produktin kozmetik të importuar;



c) përmbajtjen nominale në momentin e paketimit, të dhëna në peshë ose vëllim, me përjashtim të rastit kur paketimi përmban më pak se 5 gr ose 5 ml, mostra dhuruese ose paketime njëpërdorimshe. Për produktet e parapaketuara, të cilat normalisht shiten veçmas, ku detajet mbi peshën apo vëllimin e tyre nuk janë domethënëse, nuk jepet përmbajtja me kusht që të paraqitet në paketim numri i artikujve. Ky informacion nuk është i nevojshëm nëse numri i artikujve shihet lehtësisht nga jashtë ose nëse produkti normalisht shitet veçmas;

ç) datën deri në të cilën produkti kozmetik, i ruajtur në kushte të përshtatshme, do të vazhdojë të përmbushë funksionin e tij fillestar dhe veçanërisht do të jetë në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Data në vetvete ose detaje të paraqitjes së saj në paketim paraprihen nga simboli i miratuar ose nga fjalët “këshillohet përdorimi para fundit të”. Data e jetëgjatësisë minimale shprehet qartë dhe përbëhet sipas këtij rendi: nga muaji dhe viti ose nga dita, muaji dhe viti. Nëse shihet e arsyeshme, këtij informacioni do t’i shtohen të dhëna mbi kushtet që duhet të plotësohen, me qëllim garantimin e jetëgjatësisë së deklaruar. Shënimi i datës së jetëgjatësisë minimale nuk është i detyrueshëm për produktet kozmetike me një minimum jetëgjatësie prej më shumë se 30 muajsh. Për produkte të tilla paraqiten të dhëna mbi periudhën pas hapjes së produktit, gjatë së cilës ai është i sigurt dhe mund të përdoret pa e dëmtuar konsumatorin;

d) masat e veçanta që duhen ndjekur për përdorimin, si dhe çdo informacion i veçantë i kujdesit paraprak për produktet kozmetike për përdorim profesional;

dh) numrin e lotit të prodhimit ose referenca për identifikimin e produktit kozmetik. Në rast se për arsye praktike kjo nuk është e mundur, për shkak se produkti kozmetik është tepër i vogël, ky informacion do të paraqitet vetëm në paketim;

e) funksionin e produktit kozmetik, nëse nuk është i qartë nga prezantimi i tij;

ë) listën e përbërësve, informacioni i cili mund të tregohet vetëm në paketim, e paraprirë nga termi “Përbërësit”. Megjithatë, elementet e mëposhtme nuk do të konsiderohen si përbërës:

i) papastërtitë të lënda e parë e përdorur;

ii) materiale teknike shpesh të përdorura në përzjerje, por jo të pranishme te produkti përfundimtar.

Parfumet, përbërjet aromatike dhe substancat e tyre të para do t’i referohen termit “parfum” ose “aromë”. Prania e substancave të parashikuara në kolonën “të tjera”, në “listën e substancave që nuk lejohen të jenë në përbërjen e produkteve kozmetike, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara”, do të paraqitet në listën e përbërësve, përveç termave “parfum” ose “aromë”. Lista e përbërësve hartohet në rendin zbritës të peshës së përbërësve në momentin e përgatitjes së produktit kozmetik. Përbërësit në përqendrim më pak se 1 për qind mund të listohen në ndonjë rend tjetër pas atyre në përqendrim më shumë se 1 për qind. Të gjithë përbërësit e pranishëm në formën e nanomaterialeve, të cilët ndiqen nga fjala “nano” në kllapa, tregohen në mënyrë të qartë në listën e përbërësve. Substancat ngjyuese, të ndryshme nga ngjyuesit e flokëve, mund të listohen në një rend tjetër, pas përbërësve të tjerë kozmetikë. Për produktet kozmetike dekorative, që tregtohen në disa nuanca ngjyrash, me përjashtim të atyre të destinuara për ngjyerjen e flokëve, mund të përmenden vetëm nëse shtohen fjalët “mund të përmbajë” ose simboli “+/-”. Emërtimi CI (*Color Index*) përdoret sipas rastit.

2. Në rastet kur, për arsye praktike, është e pamundur të vendoset në etiketë informacioni i përmendur në shkronjat “d” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, informacioni paraqitet në një fletë përshkruese brenda ambalazhit ose bashkëlidhur tij.

3. Në rastin e sapunëve të tualetit/të vaskave dhe produkteve të tjera të vogla ku, për arsye praktike, është e pamundur vendosja e informacionit, sipas shkronjës “ë”, të pikës 1, të këtij neni, ky informacion shënohet në ambalazhin primar të produktit kozmetik, të ekspozuar për shitje.

4. Për produktet kozmetike, të cilat nuk janë të parapaketuara, që paketohen në pikën e shitjes, sipas kërkesës së blerësit, ose parapaketohen për shitje të menjëhershme, ministri përgjegjës për shëndetësinë nxjerr udhëzime për rregullat e hollësishme për informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 17

### **Deklarata e produktit dhe gjuha e etiketimit**

1. Në etiketimin, bërjen të disponueshëm në treg dhe publicitetin e produktit kozmetik, teksti, emrat, marka e tregtimit, pikturat dhe shenjat e tjera



nuk lejohen të përdoren për të krijuar perceptimin që këto produkte kanë karakteristika apo funksione, të cilat në të vërtetë nuk i kanë.

2. Informacioni në etiketën e produktit kozmetik është në gjuhën shqipe.

Neni 18

### Aksesi në informacion për publikun

1. Pa cenuar sekretin tregtar dhe të drejtën e pronësisë intelektuale, personi përgjegjës siguron që të bëjë lehtësisht të aksesueshëm për publikun, me anë të çdo mënyre të përshtatshme, informacionin për përbërjen cilësore e sasiore të produktit kozmetik dhe, në rastin e parfumit e të përbërjeve aromatike, emrin e kodin e përbërjes dhe identitetin e furnitorit, si dhe të dhënat ekzistuese për efektet e padëshiruara dhe efektet e padëshiruara të rënda, që shkaktohen nga përdorimi i produktit kozmetik.

2. Informacioni sasior në lidhje me përbërjen e produktit kozmetik, që kërkohet të bëhet i aksesueshëm për publikun, kufizohet vetëm për substancat e rrezikshme, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për këto substanca.

Neni 19

### Publiciteti

1. Publiciteti për produktet kozmetike përfshin publicitetin e produkteve, që bëhen të disponueshme në treg në Republikën e Shqipërisë.

2. Publiciteti për produktet kozmetike nuk përfshin:

a) publicitetin për produktet kozmetike drejtuar personelit të kualifikuar shëndetësor;

b) vizitën nga përfaqësuesit mjekësorë të personeli i kualifikuar shëndetësor, për promovimin e produkteve kozmetike. Përfaqësuesit mjekësorë janë informues mbi të dhënat shkencore të produktit kozmetik;

c) dhurimin e kampionëve;

ç) sponsorizimin e pjesëmarrësve në kongrese shkencore që ndiqen nga personeli i kualifikuar shëndetësor;

d) etiketimin dhe fletudhëzuesit e produktit kozmetik.

KREU V

MBIKËQYRJA E BRENDSHME E TREGUT

Neni 20

### Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatueshmërisë së këtij ligji dhe akteve ligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, ka këto përgjegjësi:

a) kontrollon përputhshmërinë me këtë ligj nëpërmjet kontrolleve të brendshme të tregut të produkteve kozmetike të bëra të disponueshme në treg;

b) kryen kontrollet e duhura të produkteve kozmetike dhe kontrolle të operatorëve ekonomikë në një shkallë të përshtatshme, nëpërmjet dokumentacionit të produktit dhe, sipas rastit, nëpërmjet kontrolleve fizike dhe laboratorike, duke u bazuar te mostrat e duhura, si dhe përputhshmërinë me parimet e praktikave të mira të prodhimit;

c) kontrollon subjektet, që aplikojnë produktet kozmetike, qofshin këto subjekte mjekësore ose jomjekësore;

ç) inspekton personin përgjegjës të produkteve kozmetike;

d) merr masat për ndalimin e produktit kozmetik në treg, në rastet kur produkti vlerësohet i rrezikshëm për shëndetin e njeriut;

dh) monitoron përputhjen me parimet e praktikës së mirë të prodhimit;

e) kërkon informacion për gjurmueshmërinë e produktit kozmetik;

ë) informon publikun mbi sigurinë e produkteve kozmetike;

f) i komunikon menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë masat e marra dhe çdo të dhënë mbështetëse.

3. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, kërkon nga personi përgjegjës marrjen e masave, përfshirë veprimet korigjuese për ta sjellë produktin kozmetik në përputhje me kërkesat ligjore, për ta tërhequr atë nga tregu ose për ta kthyer mbrapsht, brenda një periudhe kohore të përcaktuar në përputhje me natyrën e riskut, në rastet e mëposhtme të mospërputhshmërisë me:





- a) praktikën e mirë të prodhimit;
- b) vlerësimin e sigurisë;
- c) dosjen e informacionit për produktin;
- ç) njoftimin;
- d) kufizimet për substancat e caktuara të produkteve kozmetike;
- dh) kërkesat për testimin në kafshë;
- e) kërkesat për etiketimin;
- ë) kërkesat për publicitetin;
- f) aksesin e informacionit për publikun;
- g) komunikimin për efektet e padëshirueshme;
- gj) informacionin për substancat.

4. Personi përgjegjës siguron marrjen e masave të referuara në pikën 3, të këtij neni, për të gjitha produktet që janë bërë të disponueshme në treg.

5. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, merr të gjitha masat e përshtatshme për ndalimin ose kufizimin e bërjes së disponueshëm në treg të produktit kozmetik, tërheqjen e tij nga tregu ose kthimin e tij mbrapsht, në rastet e mëposhtme:

a) kur është i nevojshëm një veprim i menjëhershëm në rastet e rrezikut serioz për shëndetin e njerëzve; ose

b) kur personi përgjegjës nuk ka marrë masat e referuara në pikën 3, të këtij neni, brenda periudhës së përcaktuar nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.

6. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, kërkon nga shpërndarësi marrjen e masave, përfshirë veprimet korigjuese për ta sjellë produktin kozmetik në përputhje me kërkesat ligjore, për ta tërhequr atë nga tregu ose për ta kthyer mbrapsht, brenda një periudhe kohore të përcaktuar, në përputhje me natyrën e rrezikut, në rastet e mospërputhshmërisë me detyrimet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

7. Në rastet kur inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, konstaton ose ka gjithë bazën e arsyeshme përkatëse që një produkt kozmetik, megjithëse është në përputhje me kërkesat e referuara në pikën 3, të këtij neni, paraqet rrezik serioz për shëndetin e njerëzve, ai merr të gjitha masat e parashikuara në këtë ligj për të siguruar që produkti ose produktet në fjalë janë tërhequr nga tregu, janë kthyer mbrapsht ose është kufizuar bërja e disponueshme e tyre në treg.

8. Në çdo rast të masave për rrezikun serioz, inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 21

### **Marrja e mostrave dhe analizat**

1. Kontrolli dhe marrja e mostrave për analizim të produktit kozmetik bëhen nga inspektorët, që mbulojnë fushën e shëndetësisë, sipas ligjit për inspektimin.

2. Inspektorët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, duhet të identifikohen me kartën e inspektorit, të lëshuar nga Inspektorati Qendror.

3. Analizat laboratorike të mostrave të produkteve kozmetike bëhen në laboratorët e akredituar. Rezultati përfundimtar i analizave i dorëzohet inspektorit brenda një periudhe kohe prej 10 ditësh nga çasti i dorëzimit të mostrës për analizim.

Neni 22

### **Komunikimi i efekteve të padëshiruara**

1. Në rastet e efekteve të padëshiruara serioze, personi përgjegjës dhe shpërndarësit njoftojnë pa vonesë inspektoratin, që mbulon fushën e shëndetësisë, për situatën e krijuar, duke dhënë specifikimet e mëposhtme:

a) të gjitha efektet e padëshiruara serioze, të cilat janë të njohura dhe arsyetisht të pritshme për produktin;

b) emrin e produktit kozmetik, duke dhënë specifikimet përkatëse;

c) masat korigjuese të marra për këtë produkt (nëse ka).

2. Në rastet kur personi përgjegjës raporton pranë inspektoratit, që mbulon fushën e shëndetësisë efekte të padëshirueshme serioze mbi produktin kozmetik përkatës, ky i fundit ia përcjell menjëherë këtë informacion ministrisë.

3. Në rast se përdoruesi fundor ose profesionisti i shëndetit raporton efekte të padëshirueshme serioze pranë inspektoratit, që mbulon fushën e shëndetësisë, mbi produktin kozmetik të përdorur, ky i fundit ia përcjell menjëherë këtë informacion ministrisë dhe personit përgjegjës.

4. Ministria përdor informacionin e përmendur në këtë nen për qëllime të mbikëqyrjes së tregut, analizë të tregut, vlerësim dhe informacion për konsumatorin.

Neni 23

### **Informacion mbi substancat**

1. Nëse ka dyshime serioze lidhur me sigurinë e ndonjë prej substancave përbërëse të produktit



kozmetik, inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, i kërkon personit përgjegjës të dorëzojë një listë të produkteve kozmetike, për të cilat është përgjegjës dhe që përmbajnë këtë substancë. Në listë paraqiten përqendrimit e kësaj substance në përbërjen e produktit kozmetik.

2. Inspektorati, që mbulon fushën e shëndetësisë, ia përcjell këtë listë ministrisë, e cila merr masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit kozmetik.

#### KREU VI SHËRBIMET PËR APLIKIMIN E PRODUKTEVE KOZMETIKE

Neni 24

##### **Subjektet që aplikojnë produkte kozmetike**

Aplikimi i produkteve kozmetike kryhet nga:

- a) individë;
- b) subjekte jomjekësore;
- c) subjekte mjekësore;
- ç) subjekte mjekësore të specializuara.

Neni 25

##### **Individët**

1. Çdo individ ka të drejtë të vetëpërdorë produkte kozmetike, të vendosura në treg sipas udhëzimeve të etiketimit të jashtëm ose fletudhëzuesit të produktit kozmetik.

2. Përrjashtim nga rregulli i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, bëjnë produktet kozmetike të destinuara për t'u përdorur nga shërbimet e specializuara mjekësore ose jomjekësore.

3. Efektet nga mospërdorimi dhe mosruajtja, sipas udhëzimeve të produktit kozmetik, janë përgjegjësi e individit.

4. Çdo individ, që përdor produkte kozmetike për çdo efekt të padëshirueshëm ose jo të zakonshëm të lidhur me përdorimin e produktit kozmetik, njofton inspektoratin që mbulon fushën e shëndetësisë.

Neni 26

##### **Subjektet jomjekësore**

1. Subjektet jomjekësore janë subjekte që ofrojnë shërbime të ndryshme, pjesë e të cilave është aplikimi i produkteve kozmetike.

2. Subjektet jomjekësore mbajnë një regjistër të veçantë për të gjitha produktet kozmetike që ato përdorin, duke evidentuar emrin e subjektit nga i cili kanë marrë produktin.

3. Subjektet jomjekësore kanë staf të kualifikuar për përdorimin profesional të produkteve kozmetike, nëse produkti kozmetik që aplikojnë kërkon përdorim nga një përdorues profesionist.

Neni 27

##### **Subjektet mjekësore**

1. Subjektet mjekësore janë subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin për ofrimin e shërbimeve mjekësore, pjesë e të cilave është dhe përdorimi i produkteve kozmetike.

2. Aplikimi i produkteve kozmetike në subjektet mjekësore kryhet nga profesionistë shëndetësorë, të kualifikuar për këtë qëllim.

KREU VII

#### KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 28

##### **Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) veprimi i kryer në kundërshtim me nenin 4, të këtij ligji, dënohet me konfiskim të produkteve kozmetike dhe me 500 000 (pesëqind mijë) lekë gjobë;

b) moskryerja e detyrave të përcaktuara nga personi përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij ligji, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë;

c) moskryerja e detyrave të përcaktuara nga shpërndarësi, sipas përcaktimeve të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë;

ç) mosnjoftimi, sipas përcaktimeve të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

d) vendosja në treg e produkteve kozmetike, që përmbajnë substanca të ndaluara, sipas nenit 13, të këtij ligji, dënohet me konfiskim të produkteve kozmetike dhe me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

dh) mosrespektimi i kërkesave të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, lidhur me efektet e padëshirueshme serioze të produktit kozmetik nga personi përgjegjës dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë;

e) shkelja e pikës 3, të nenit 26, të këtij ligji, dënohet me 500 000 (pesëqind mijë) lekë gjobë;



ë) aplikimi i produkteve kozmetike nga subjekte mjekësore pa profesionistë shëndetësorë të kualifikuar dënohet me 500 000 (pesëqind mijë) lekë gjobë.

2. Autoriteti përgjegjës për vendosjen e masave të përcaktuara në këtë nen është inspektorati përgjegjës për fushën e shëndetësisë.

3. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të marrë, sipas këtij neni, bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

4. Ekzekutimi i dënimeve me gjobë, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

#### KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 4, dhe 13, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 1; 12, pika 1, shkronja “ç”, nënndarja “i”; dhe 16, pika 4, të këtij ligji.

Neni 30

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10115, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

#### LIGJ Nr. 27/2017

### **PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007, “PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

1. Brenda datës 31.12.2017, ish-të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore dhe plotësojnë kriteret e neneve 4 e 5, të këtij ligji, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kujdestarit ligjor, paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën, me shkrim, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për dënimin penal të padrejtë, sipas formularit të paraqitur në aneksin “A”, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, sjell humbjen e së drejtës së dëmshpërblimit për ish-të dënuarin politik, i cili bën pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore. Sipas këtij ligji, ish-i dënuari politik i regjimit komunist, që bën pjesë në kategorinë parësore, personi i autorizuar apo kujdestari i tij ligjor nuk mund të rivendosen në afat për paraqitjen e kërkesës pas datës 31.12.2017.”.

Neni 2

Në nenin 23, paragrafi i dytë, data “1.7.2009” zëvendësohet me datën “31.12.2017”.

Neni 3

##### **Dispozita kalimtare**

Aplikimet e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë pas datës 1.7.2009, nga subjektet e kategorisë parësore, konsiderohen të vlefshme. Ministria e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, të paraqitura nga subjektet e kategorisë parësore, pas datës 1.7.2009.



Neni 4  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10116, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 28/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 107/2014, “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

1. Kudo në ligj emërtimet “Plani i Përgjithshëm i Territorit” dhe “Plani i Përgjithshëm Kombëtar” zëvendësohen me emërtimin “Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit” (PPKT) dhe emërtimi “Regjistri i Integruar i Territorit” zëvendësohet me emërtimin “Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit”.

2. Kudo në ligj ku përshkruhen përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit fjalët “planifikim dhe zhvillim i territorit” zëvendësohen me fjalët “planifikim i territorit”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

- Në pikën 1 hiqen fjalët “dhe zhvillimit”.
- Pika 33 ndryshohet si më poshtë:

“33. “Regjistër Kombëtar i Planifikimit të Territorit”, në vijim regjistri, është baza e të

dhënave shtetërore, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës, në të cilin regjistrohen dhe administrohen nga autoritetet kombëtare dhe vendore, në mënyrë të pavarur, të dhënat për territorin, dokumentet e planifikimit, në proces miratimi apo të miratuara, së bashku me të drejtat apo kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre, si dhe studime apo materiale të tjera në funksion të planifikimit e me interes për publikun, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.”.

3. Pika 38 ndryshohet si më poshtë:

“38. “Rregullore e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit” është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen rregullat për administrimin e mirëmbajtjen e të dhënave, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe të personave të tjerë, fizikë e juridikë, për sa i përket mirëmbajtjes e dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në regjistër.”.

4. Pas pikës 39 shtohet pika 39/1 me këtë përmbajtje:

“39/1. “Sistemi elektronik i lejeve” është sistemi i integruar i programeve dhe pajisjeve elektronike, i përdorur për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin digjital) e të dhënave dhe dokumenteve, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për leje në fushën e ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.”.

5. Pas pikës 44 shtohet pika 44/1 me këtë përmbajtje:

“44/1. “Zonë e zhvillimit” është territori në funksion të procesit të zhvillimit, pjesë e një njësie strukturore, sipas përcaktimeve të planit të detajuar vendor.”.

**Neni 3**

Në nenin 9, pika 1, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) për kontrollin e përputhshmërisë së akteve të botuara në regjistër me ligjet, dokumentet e planifikimit në fuqi;”.

**Neni 4**

Në nenin 12, pika 2, bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:  
“a) miratuar nismën për hartimin apo rishikimin e planit të përgjithshëm vendor;”.
- Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:



“b) miratuar planin e përgjithshëm vendor;”.

3. Shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 13, pika 1, në shkronjën “d”, fjalët “dokumenteve vendore të planifikimit” zëvendësohen me fjalët “planit të përgjithshëm vendor”.

Neni 6

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 5, 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“5. Nisma private duhet të mbështetet nga pronarët që kanë në pronësi, jo më pak se 51 për qind të sipërfaqes së zonës së zhvillimit, për të cilën propozohet plani i detajuar vendor.

6. Kryetari i bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detajuar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palët e interesuara përmes një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe kryen takime publike me ta, në rast se kërkohet.

7. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit.”.

2. Pikat 10 dhe 11 shfuqizohen.

3. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. Plani i detajuar vendor regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni vetëm pasi të jenë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, me kërkesë të zhvilluesit.”.

4. Në pikën 13, fjala “zhvillimit” zëvendësohet me fjalën “planifikimit”.

5. Në pikën 14, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Dokumenti i planit të detajuar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim.”.

Neni 7

Titulli i seksionit III, të kreut II, ndryshohet si më poshtë:

“Bashkërendimi, këshillimi dhe shqyrtimi publik i dokumenteve të planifikimit në nivel qendror dhe planit të përgjithshëm vendor”.

Neni 8

Në nenin 24, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon një ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi, përpara çdo vendimmarrjeje që ka lidhje me dokumentet e planifikimit në nivel qendror dhe me planin e përgjithshëm vendor dhe i përsërit ato, sipas nevojës, me qëllim informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve.”.

Neni 9

Në nenin 26 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit do të jetë subjekt vlerësimi, në përshtatje me faktorët e rinj, socialë, ekonomikë dhe mjedisorë, të paktën në fund të çdo 5-vjeçari, në përputhje me kornizën kohore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”.

2. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

3. Rregullat dhe procedura e ndryshimit të planeve apo rishqyrtimit të plotë të tyre, sipas këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.”.

Neni 10

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi



për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit.”.

#### Neni 11

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “si dhe hapësirave publike”.

2. Në pikën 2, fjalët “i parashikuar në” zëvendësohen me fjalët “në përputhje me”.

#### Neni 12

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Kërkesa shoqërohet nga kalendari i ri i punimeve dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit, sipas nenit 52 të këtij ligji.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

#### Neni 13

Në nenin 42, pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Në fund të procesit të zhvillimit, autoriteti përgjegjës i planifikimit lëshon certifikatën e përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit, si dhe zbatimin e kritereve të dokumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit.

2. Në të gjitha rastet, subjekti që kryen punimet lëshon deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi.

3. Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit.”.

#### Neni 14

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Aplikimi për leje ndërtimi duhet të kryhet përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.

Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.”

2. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Autoriteti përgjegjës i zhvillimit nuk mund të përcaktojë procedura apo kërkesa të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloren e zhvillimit për pajisjen me leje në fushën e ndërtimit.”.

#### Neni 15

Në nenin 46, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore.”.

#### Neni 16

Në nenin 52, pika 1, pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) refuzimi i lejes së ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;”.

#### Neni 17

Në nenin 54, shkronja “b”, hiqen fjalët “dhe kontrollin e zhvillimit”.

#### Neni 18

Në nenin 56, pika 1, hiqen fjalët “zhvillimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit”.

#### Neni 19

Në nenin 57, pika 1, shkronja “ç” shfuqizohet.

#### Neni 20

### Dispozita kalimtare

1. Për lejet e ndërtimit, të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit të punimeve, përcaktuar në formularin e lejes përkatëse, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, shtyrja e afatit mund të kryhet nga autoriteti përgjegjës, me kërkesë të zhvilluesit, me kushtin që të mos kenë kaluar më shumë se 10 vjet nga data e miratimit të lejes së ndërtimit dhe subjekti të ketë paguar paraprakisht penaltitetet e parashikuara nga neni 52,



i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

2. Në rast se punimet e ndërtimit për këto leje nuk kanë filluar, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të dokumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit, shtyrja e afatit të lejes përkatëse bëhet pas përputhshmërisë me planin e përgjithshëm vendor.”.

Neni 21

#### Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10117, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### LIGJ

Nr. 29/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË - DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI

#### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10118, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

(Numri i Veprimit 48466)

### MARRËVESHJE HUAJE

(Hekurudhat shqiptare - Rehabilitimi i hekurudhës Tiranë-Durrës dhe ndërtimi i një linje hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Datë [\_\_\_\_\_]

MARRËVESHJE e datës [\_\_\_\_\_], ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (“Huamarrësi”) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”).

### HYRJE

Duke pasur parasysh se Banka është krijuar për të siguruar financim për projekte të veçanta për të nxitur tranzicionin drejt ekonomive të orientuara drejt tregut të hapur dhe për të promovuar nismat private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, të angazhuara për dhe në zbatim të parimeve të demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;



duke pasur parasysh se Huamarrësi synon të zbatojë projektin, siç përshkruhet në shtojcën 1, e cila është hartuar për të ndihmuar në rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe Durrësit dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore për t'u lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës;

duke pasur parasysh se Projekti do të zbatohet nga Hekurudha Shqiptare sh.a. ("Njësia e Projektit") me asistencë financiare nga Huamarrësi;

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar asistencën nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

duke pasur parasysh se Banka është në proces të vënies në dispozicion të fondeve për bashkëpunim teknik në formë granti për të ndihmuar në zbatimin e një pjese të Projektit;

duke pasur parasysh se Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor ("KIBP") ka siguruar fondet e grantit në vlerë prej EUR [1.215.000] për përgatitjen e projektit të detajuar dhe dokumenteve të tenderit dhe mbikëqyrjen e punimeve për pjesën A të projektit;

duke pasur parasysh se KIBP-i pritet të sigurojë një grant prej [35,435,000 EURO] milionë për të bashkëfinancuar deri në 50 për qind të kostos kapitale të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe mbështetjen e zbatimit të projektit në përputhje me metodologjinë e tyre të re për të mbështetur investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor, sipas disponueshmërisë së fondeve që konfirmohen në dhjetor 2016; dhe

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord, ndër të tjera, për sa më sipër të japë një hua për Huamarrësin në shumën 36,870,000, EURO sipas termave dhe kushteve të përcaktuara apo referuara në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen e Projektit me datën e caktuar në të ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Bankës ("Marrëveshja e Projektit" siç është përcaktuar në termat dhe kushtet standarde);

sa më sipër, palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni I

### **Afatet dhe kushtet standarde; përkufizime**

Seksioni 1.01. Përfshirja e afateve dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e afateve dhe kushteve standarde të Bankës, të datës 1 dhjetor 2012, janë

përfshirë dhe bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashtruar plotësisht në të, megjithatë, sipas ndryshimeve të mëposhtme (dispozitat e ndryshuara më poshtë të referuara si "Afatet dhe kushtet standarde"):

a) Përkufizimi i "Euro", "EUR" apo "€" në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, mund të ndryshohet për t'u lexuar si më poshtë:

"Euro", "EUR" apo "€" nënkupton valutën e ligjshme të shteteve anëtare të Bashkimit Europian që kanë miratuar monedhën e përbashkët, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Europian në lidhje me bashkimin ekonomik dhe monetar"

b) Përkufizimet për "Praktikë Shtrënguese" "Praktika e Marrëveshjes së Fshehtë", "Praktika Korruptuese" dhe "Praktika Mashtruese" në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të hiqen tërësisht.

c) Përkufizimet për "Praktikë e Ndaluar" në seksionin 2.02 të afateve dhe kushteve standarde për qëllime të Marrëveshjes do të ndryshojnë si më poshtë:

"Praktikë e Ndaluar" nënkupton një praktikë shtrënguese, një praktikë të marrëveshjes së fshehtë, një praktikë korruptuese, një praktikë mashtruese, një keqpërdorim të burimeve të Bankës, një praktikë penguese apo një vjedhje, siç janë përkufizuar këta terma në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës datë 5 nëntor 2015 dhe siç janë interpretuar më tej këta terma në Udhëzimet e Praktikave të Ndaluar për Veprimet e BERZH-it të muajit shkurt 2016."

d) Përkufizimi i "Faqe Referimi" në seksionin 2.02 të termave dhe kushteve standarde për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, duhet të ndryshohet me tekstin si vijon:

"Faqe Referimi" nënkupton paraqitjen e: (i) për Hua të shprehura në USD ose £, normave ndërbankare të ofruara në Londër të bankave më të mëdha për depozita në Valutën e Huas të strukturuar si faqe LIBOR01 dhe LIBOR02 në shërbimet e Thomson Reuters (apo faqe të tjera të tilla që mund të zëvendësojnë faqet LIBOR01 dhe LIBOR02 në shërbimet e Thomson Reuters për qëllim të shfaqjes së normave ndërbankare Londër për depozita në Valutën e Huas); dhe (ii) për Hua të shprehura në euro, norma ndërbankare të





ofruara në zonën euro për depozita në Valutën e Huas të strukturuar si faqe EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters (apo faqe të tjera që mund të zëvendësojnë EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters për qëllime të paraqitjes së normave ndërbankare të ofruara në eurozonë për depozita në Valutën e Huas).”

e) Përkufizimi i “Ditës së Synuar” në seksionin 2.02 të termave dhe kushteve standarde për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet në tekst si më poshtë:

“Dita e Synuar” nënkupton çdo ditë në të cilën sistemi i Transferimit Ekspres Transeuropian Automatik i Shlyerjes Bruto në Kohë Reale është i hapur për shlyerjen e pagesave në euro.”

f) Seksioni 3.04(a) i termave dhe kushteve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet në tekst si më poshtë:

“a) Nëse Huaja është subjekt i Normës së Ndryshueshme të Interesit, atëherë, për qëllime të paragrafit 3.04 (b) më poshtë, Norma Përkatëse e Interesit në Treg, do të jetë:

i) për Periudhën e parë të Interesit për çdo Tërheqje, norma e ofruar vjetore për depozita, në Valutën e Huas që shfaqet në Faqen e Referimit në orën 11:00 paradite, siç është e zbatueshme, ora e Londrës (për USD apo £) apo ora e Brukselit (për Euro), në Datën e përkatëse të Përcaktimit të Interesit, e cila barazon kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi (apo nëse kjo normë nuk shfaqet në Faqen e Referimit për të njëjtën periudhë që me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi, por normat (“Normat e Referimit”) shfaqet në Faqen e Referimit për një periudhë më të shkurtër apo më të gjatë sesa kohëzgjatja e kësaj Periudhe Interesi, Norma Përkatëse e Interesit në Treg do të jetë norma (e rrumbullakosur lart nëse është e nevojshme me katër dhjetëshe) që do të zbatohet për një periudhë të njëjtë me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi siç përcaktohet nëpërmjet përdorimit të lidhjes së drejtpërdrejtë, duke iu referuar Normës së Referimit që paraqitet në Faqen e Referimit për periudhën pasardhëse më të shkurtër në gjatësi sesa kohëzgjatja e kësaj Periudhe Interesi dhe Norma e Referimit që paraqitet në Faqen e Referimit për periudhën pasardhëse më të gjatë sesa kjo Periudhë Interesi); dhe

i) për çdo Periudhë Interesi pasardhëse, norma vjetore e ofruar për depozita në Valutën e Huas e cila paraqitet në Faqen e Referimit në 11:00

paradite, siç zbatohet, me orën e Londrës (për USD apo £) apo orën e Brukselit (për euro), në Datën e Përcaktimit të Interesit për periudhën më të afërt me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi (ose, nëse dy periudha janë njësoj afër kohëzgjatjes së kësaj Periudhe Interesi, mesatare e dy normave përkatëse).

Me kusht që:

1. Nëse, për ndonjë arsye, Norma e Interesit të Tregut Përkatës nuk mund të përcaktohet në këtë periudhë duke iu referuar Faqes së Referimit, Norma e Interesit e Tregut Përkatës do të jetë norma vjetore që përcakton Banka si mesatare (e rrumbullakosur lart, nëse është e nevojshme me katër dhjetëshe) të normave të ofruara vjetore për Depozita në Valutën e Huas në një shumë të krahasueshme me një pjesë të Huas, sipas një Norme të Ndryshueshme Interesi të planifikuar për t’u paguar gjatë Periudhës së Interesit përkatës për një periudhë të njëjtë me këtë Periudhë Interesi që u citohet bankave kryesuese në tregun ndërbankar Londër (për USD ose £) ose tregun ndërbankar në eurozonë (për Euro) siç i këshillohet Bankës nga të paktën dy banka të mëdha aktive në tregun ndërbankar të Londrës (për USD ose £) ose tregun ndërbankar të Eurozonës (për Euro) të përzgjedhur nga Banka; dhe

2. Nëse në vijim të termave të përcaktuara në paragrafin 3.04(a), Norma e Interesit në Treg do të jetë nën zero atëherë do të konsiderohet zero.”

g) Paragrafi 3.04 i termave dhe kushteve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet për të futur një paragraf të ri 3.04(e), i cili do të jetë si më poshtë:

“e) Nëse ka ndodhur apo vazhdon të ndodhë ndonjë nga rastet e parashikuara në paragrafin 7.06 të termave dhe kushteve standarde, Banka mund t’i kërkojë Huamarrësit të paguajë Interesin për pjesën e Huas, nëse ka, i cili i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit, jo me këtë Normë Interesi Fikse, por me Normë të Ndryshueshme Interesi”.

h) Paragrafi 3.09(a)(iii) i termave dhe kushteve standarde të interesit për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshojë si më poshtë: “(iii) norma vjetore e interesit e ofruar, sipas rastit, në tregun ndërbankar Londër (për USD apo £) apo në tregun ndërbankar Eurozonë (për euro), për Datën e Përcaktimit të Interesit të Papaguar për një depozitë në Valutën e Huas të një shume të krahasueshme me shumën e vonuar për periudhë



të njëjtë me Periudhën e Interesit të Papaguar ose, nëse ndodh një Çrregullim i Tregut, norma që shpreh si përqindje vjetore koston e Bankës së financimit të Huas nga çfarëdo burimi që banka mund të përzgjedhë në mënyrë të arsyeshme (me zgjedhje të Bankës, Norma e Interesit të Tregut Përkates, sipas rastit), me kusht që nëse norma sipas këtij nënparagrafi 3 (iii) do të ishte zero, norma do të konsiderohej zero”.

i) Paragrafi 3.10(b)(2) i termave dhe kushteve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të ndryshohet si më poshtë: “çdo pjesë e Huas që i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit përshpejtohet në pajtim me paragrafin 7.06 apo paguhet para maturimit të përcaktuar apo i nënshtrohet Normës së Ndryshueshme të Interesit sipas paragrafit 3.04(e) të termave dhe kushteve standarde; ose”.

j) Paragrafi 3.13(a)(1)(B) i termave dhe kushteve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të ndryshojë si më poshtë: “(B) norma, siç njoftohet nga Banka për Huamarrësin sa më shpejt që të vihet në zbatim dhe në çdo rast para se interesi të paguhet në pajtim me Periudhën e Interesit Përkates, e cila shpreh si normë përqindjeje vjetore, koston e Bankës së financimit të Huas nga çdo lloj burimi që Banka mund të përzgjedhë vetë (apo me zgjedhje të Bankës, Normën e Interesit Përkates të Tregut, nëse ka), me kusht që nëse norma sipas këtij nënparagrafi (B) do të jetë nën zero, përqindja do të konsiderohet zero; dhe”

h) Paragrafi 8.04(b)(iii) i termave dhe kushteve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje ndryshon në tekst si më poshtë: “(iii) Në rastet kur Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit emëron një arbitër, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit është i lirë të zgjedhë çdo person që ai/ajo konsideron të përshtatshëm të veprorë si arbitër në zbatim të neneve 9.2 dhe/ose 9.3 të Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL.”

Paragrafi 1.02 Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë hyrjen dhe shtojcat), përveç rasteve kur shprehet ndryshe apo konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që i jepet, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që i jepet aty dhe termat e mëposhtëm kanë kuptim si më poshtë:

“Plan Veprimi Mjedisor dhe Social” nënkupton planin e zbutjes dhe përmirësimit të masave mjedisore dhe sociale, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Projektit.

“Viti Fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

“Kuari i Përvetësimit të Tokës” nënkupton dokumentin kuadër të vendosjes dhe kompensimit të përgatitur në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe PR 5, në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të përgatitur dhe të miratuar nga autoritetet përkatëse dhe të vënë në dispozicion për publikun.

“Plani i Përvetësimit të Tokës” nënkupton planin e përvetësimit të tokës dhe zhvendosjes jovullnetare që jep Huamarrësi (nëpërmjet Njësisë së Projektit) dhe i miratuar nga Banka në përputhje me Paragrafin 5.01 (i) të kësaj Marrëveshjeje.

“MTI” nënkupton Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës në Republikën e Shqipërisë.

“NJZP” nënkupton Njësinë e Zbatimit të Projektit të përmendur në përputhje me paragrafin 2.03 të Marrëveshjes së Projektit.

“PR 5” nënkupton kërkesën 5 të zbatimit, siç janë kërkesa e zbatimit për Përvetësimin e Tokës, Zhvendosjen e Pavullnetshme, Zhvendosjen Ekonomike në përputhje me Politikat Mjedisorë dhe Sociale të BERZH-it (maj 2014).

“Marrëveshje Nënhuazimi” nënkupton Marrëveshjen e Huas që lidhet midis Njësisë së Projektit dhe Huamarrësit sipas paragrafit 3.01(a) dhe si e tillë Marrëveshja e Huas mund të ndryshojë herë pas here.

“Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara” nënkupton planin e angazhimit të palëve të interesuara të dorëzuar nga Huamarrësi (nëpërmjet Njësisë së Projektit) dhe të miratuar nga Banka në përputhje me paragrafin 5.01 (j) të kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 1.03. Interpretimi.

Në këtë Marrëveshje, një referencë për një nen të caktuar, paragraf apo shtojcë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të interpretohet si referencë për atë nen, paragraf apo shtojcë të caktuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

### Termet kryesorë të Huas

Paragrafi 2.01. Shuma dhe monedha  
Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas



termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 36.870.000 euro.

Paragrafi 2.02. Terma të tjerë financiarë të Huas

a) Shuma Minimale e Tërheqjes do të jetë 250,000 EURO.

b) Shuma Minimale e Parapagimit do të jetë 5,000,000 EURO.

c) Shuma Minimale e Anulimit do të jetë 1,000,000 EURO.

d) Datat e Pagesës së Interesit janë 5 maj dhe 5 nëntor të çdo viti.

e)(1)Huamarrësi paguan Huan në 24 këste gjashtëmujore të njëjta (apo pothuajse sa më të njëjta) në çdo Datë të Pagesës së Interesit, ku data e parë e Shlyerjes së Huas bie në Datën pasuese të Pagesës së Interesit menjëherë pas përvjetorit të tretë të kësaj Marrëveshjeje.

2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rastet kur: (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë pjesën përkatëse të Shumës së Huas para datës së parë të Shlyerjes së Huas, siç specifikohet në paragrafin 2.02 (e) të Marrëveshjes së Huas; dhe (ii) Banka shtyn Datën e Fundit të Vlefshmërisë të përcaktuar në paragrafin 2.02 (f) të Marrëveshjes së Huas në një datë pas datës së parë të shlyerjes së Huas, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huas do të alokohet për t'u shlyer në shumën të barabarta në disa Data të Shlyerjes së Huas, të cilat bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ndërsa Banka rregullon që shumën të alokohen siç është e nevojshme me qëllim që në çdo rast të përfitohet shumë e rumbullakosur). Banka do të njoftojë Huamarrësin për këto alokime herë pas here.

f) Data e fundit e Vlefshmërisë do të jetë data katër vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, apo një datë më e vonshme që Banka me kërkesë të Huamarrësit dhe me diskrecionin e saj mund të caktojë dhe të njoftojë Huamarrësin.

g) Norma e Komisionit të Angazhimit do të jetë 0.5% në vit.

h) Huaja është subjekt i një norme interesi të ndryshueshme. Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi mund të, si alternativë për pagesën e interesit në një Normë të Ndryshueshme Interesi në të gjitha ose ndonjë pjesë të Huas, të papaguar, të zgjedhë të paguajë interes në një normë interesi fikse në këtë pjesë të Huas, në përputhje me paragrafin 3.04 (c) të termave dhe kushteve standarde.

Paragrafi 2.03. Tërheqjet

Shuma në dispozicion mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e Planit 2 për të financuar: (1) shpenzime të bëra (ose nëse Banka bie dakord, për t'u bërë) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe punimeve që kërkohen për Projektin; dhe (2) Tarifën Front - End Fee.

Neni III

### Zbatimi i projektit

Paragrafi 3.01. Angazhime të tjera në lidhje me Projektin

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në nenet IV dhe V të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Vë në dispozicion të Njesisë së Projektit, në përputhje me Marrëveshjen e Nënhuas, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të ardhurat e Huas sipas afateve dhe kushteve të pranueshme për Bankën;

b) Ushtron të drejtat e tij sipas Marrëveshjes së Nënhuas, në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Bankës, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe për të përmbushur qëllimet për të cilat është dhënë Huaja;

c) Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, nuk emëron, ndryshon, shfuqizon apo heq dorë nga asnjë nga dispozitat e Marrëveshjes së Nënhuas;

d) Bën të mundur që Njësia e Projektit të zbatojë të gjitha detyrimet në Marrëveshjen e Projektit, duke përfshirë, pa kufizim, detyrimet e tij në lidhje me:

1) krijimin dhe funksionimin e një njësie të zbatimit të projektit, siç parashikohet në paragrafin 2.03 të Marrëveshjes së Projektit;

2) prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve nga Projekti, siç parashikohet në nenin 2.04 të Marrëveshjes së Projektit;

3) çështjet mjedisore dhe sociale, siç parashikohet në nenin 2.05 të Marrëveshjes së Projektit;

4) punësimin dhe përdorimin e konsulentëve për të ndihmuar në zbatimin e projektit, siç parashikohet në nenin 2.06 të Marrëveshjes së Projektit;

5) mbajtjen e procedurave, të dhënave dhe llogarive, përgatitjen, auditimin dhe dorëzimin në Bankë të pasqyrave financiare dhe pajisjen e



Bankës me çdo informacion tjetër relevant në lidhje me veprimet e Projektit apo Njesisë së Projektit, siç parashikohet në nenin 3.01 të Marrëveshjes së Projektit;

6) pajtueshmërinë me të gjitha kontratat lidhur me aspektet financiare dhe operationale të Projektit dhe Njesisë së Projektit, siç parashikohet në nenet 3.02, 3.03 dhe 3.04 të Marrëveshjes së Projektit;

7) sigurimin se Njësia e Projektit ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e mirëmbajtjes, të identifikuar në planin e menaxhimit të asetëve dhe ndjekjen e pagesave hyrëse për t'u përgatitur si pjesë e Projektit;

8) pagesa e të gjitha taksave, detyrimeve, tarifave ose pagesave të tjera të pagueshme në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, ofrimin, regjistrimin apo noterizimin e çdo Marrëveshjeje Projekti dhe çdo dokument tjetër që ka lidhje me këtë Marrëveshje;

9) delegimi në NJZP nëpërmjet Njesisë së Projektit të menaxhimit të përditshëm të Projektit duke përfshirë, por jo vetëm, menaxhimin e konsoliduar financiar dhe të prokurimeve;

10) vënien në fuqi, sipas nevojave, të rregullimeve në nivel dhe strukturë të tarifave të Njesisë së Projektit për të siguruar që Njësia e Projektit mund të plotësojë detyrimet e saj dhe të lejojë arritjen nga Njësia e Projektit të rikuperimit të plotë të kostos për shërbimet e saj; dhe

11) siguron, apo bëhet shkak për sigurimin, kur kërkohet, të gjitha licencat shtetërore, miratimet apo lejet e kërkuara nga Njësia e Projektit për financimin dhe zbatimin e Projektit dhe vazhdimin e biznesit të tij, duke përfshirë të gjitha miratimet dhe licencat e nevojshme për të garantuar që Njesisë së Projektit t'i jepet e drejta e përdorimit të rrugës dhe tokave të tjera të nevojshme për të zbatuar Projektin;

e) mbështet Njësinë e Projektit, siguron apo shkakton sigurimin e fondeve për Njësinë e Projektit, si dhe kur nevojiten për të arritur përfundimin e Projektit;

f) deri më 31 mars 2017, aprovohet Kodi i ri Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë.

#### Neni IV

#### **Pezullimi; përsheptimi; anulimi**

Paragrafi 4.01. Pezullimi

Më poshtë janë specifikuar për qëllime të nenit 7.01(a)(xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin në të cilin Njësia e Projektit vepron do të jetë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar apo hiqet në një mënyrë tjetër ndryshe nga ajo se si janë miratuar nga Banka me shkrim;

b) Statutet do të ndryshohen, pezullohen, shfuqizohen, anulohen apo do të hiqet dorë;

c) Kontrolli i Njesisë së Projektit do të transferohet në një palë të ndryshme nga Huamarrësi; ose

d) Njësia e Projektit ka dështuar në zbatimin e ndonjë prej detyrimeve të tij të parashikuara në Marrëveshjen e Nënhuas.

Paragrafi 4.02. Përsheptimi i Maturimit

Më poshtë specifikohet për qëllime të paragrafit 7.06 (f) të termave dhe kushteve standarde: çdo ngjarje e specifikuar në paragrafin 4.01, e cila vazhdon për tridhjetë ditë pas njoftimit të vendimit që i është dhënë nga Banka Huamarrësit, për këtë ndodhi.

#### Neni V

#### **Hyrja në fuqi**

Paragrafi 5.01. Kushtet para hyrjes në fuqi

Në vijim janë specifikuar për qëllime të paragrafit 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit:

a) Marrëveshja e Nënhuas, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, është nënshkruar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet para hyrjes së saj në fuqi apo të drejtës së Njesisë së Projektit për të bërë tërheqje në të, përveç rasteve kur hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, është përmbushur;

b) Parlamenti i Republikës së Shqipërisë ka ratifikuar këtë Marrëveshje dhe ratifikimi është botuar në Gazetën Zyrtare;

c) Marrëveshja e Projektit është nënshkruar dhe dorëzuar, dhe është autorizuar nënshkrimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes së Projektit;

d) Konfirmimi nga Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, e pranueshme për Bankën që një kontribut i kostos së Projektit do të vihet në dispozicion nga Huamarrësi dhe do të përfshihet në buxhetin vjetor përkatës;

e) Marrja nga Banka e të dhënave, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, të zotimit të financimit nga WBIF-ja;



f) NJZP-ja është strukturuar me burimet të mjaftueshme dhe staf të kualifikuar dhe të përshtatshëm në përputhje me termat e referencës të pranueshme për Bankën;

g) Caktimi nga Njësia e Projektit të konsulentëve të financuar nga grantet e dhëna nga WBIF-ja dhe Banka, për të asistuar NJZP-në me përgatitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit;

h) Banka është pajisur me prova/të dhëna nga Njësia e Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, për zbatimin e duhur të Planit të Veprimit Social dhe Mjedisor;

i) Banka ka marrë nga Njësia e Projektit Planin e Përvetësimit të Tokës për Projektin në përputhje me PR5 dhe Kuadrin e Përvetësimit të Tokës në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe

j) Banka është pajisur me të dhëna nga Njësia e Projektit, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, për zbatimin e duhur të Planin të Angazhimit të Palëve të Interesuara.

Paragrafi 5.02. Opinione ligjore

a) Për qëllime të nenit 9.03 (a) të termave dhe kushteve standarde, opinionin ose opinionet e avokatit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe në vijim janë përcaktuar si çështje shtesë për t'u përfshirë në opinionin ose opinionet që i jepen Bankës:

1) Marrëveshja e nënhuas është autorizuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në pajtim me kushtet e saj.

b) Për qëllime të seksionit 9.03 (c) të termave dhe kushteve standarde, opinionin ose opinionet e këshilltarit jepen në emër të Njesisë së Projektit nga shefi i departamentit ligjor të subjektit të Projektit dhe në vijim janë përcaktuar si çështje shtesë për t'u përfshirë në opinionin ose opinionet që do t'i dorëzohen Bankës:

1) Marrëveshja e Nënhuas është autorizuar, nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Njesisë së Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në pajtim me kushtet e saj; dhe

2) Marrëveshja e Projektit është autorizuar, nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Njesisë së Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish detyrues të Njesisë së Projektit, e zbatueshme në pajtim me termat e saj.

Paragrafi 5.03. Ndërprerja për moshyrje në fuqi  
Data e 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllimet e nenit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

#### Neni VI Të ndryshme

Paragrafi 6.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllime të nenit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave  
Bul. “Dëshmorët e Kombit”, 3  
Tiranë  
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave  
Faks:+355- 4- 2228 494

Për Bankën:  
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
One Exchange Square  
Londër EC2A 2JN  
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamentit të Operimit të Administratës  
Faks:+44-20-7338-6100

Në dëshmi të kësaj, palët nënshkruese, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në pesë kopje (tri kopje për Huamarrësin dhe dy kopje për Bankën) dhe të dorëzohet në [\_\_\_\_\_] në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: Z. Arben Ahmetaj

Titulli: Ministër i Financave

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM  
DHE ZHVILLIM

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:



### SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

1. Qëllimi i projektit është të ndihmojë Huamarrësin në rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe Durrësit me gjatësi të përafërt prej 34.17 km dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore rreth 5 km në gjatësi për t'u lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe shkëmbimi i saj me linjën ekzistuese.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, që janë subjekt i ndryshimeve siç mund të bien dakord herë pas here Banka dhe Huamarrësi:

Pjesa A: Punimet e ndërtimit në lidhje me: (i) rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe Durrësit, me një gjatësi të përafërt prej 34.17 km; dhe (ii) ndërtimin e një linje të re hekurudhore rreth 5 km në gjatësi për t'u lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe shkëmbimi i saj me linjën ekzistuese.

Pjesa B: Shërbimet e Konsulencës për mbështetje në zbatimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve për pjesën A.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2020.

### SHTOJCA 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela që i bashkëngjitet kësaj shtojce përcakton kategoritë, shumën e huas të caktuar për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në çdo kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra para datës së Marrëveshjes së Huas.

#### Bashkëlidhje e shtojcës 2

Kategoria	Shuma e huas e alokuar në monedhën e huas	Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar
(1) Punime ndërtimi për pjesën A financuar nga huaja	36,501,300 EURO	100% duke përfshirë çdo taksë
(2) Komisioni në kohën e blerjes fillestare për investim	368,700 EURO	100%
<b>Totali</b>	<b>36,870,000 EURO</b>	

Vlerësimet e kostos së Projektit dhe Plani i Financimit

Kostot e Projektit & Plani i Financimit (EURm)	BERZH Hua	BERZH Granti	EU/WBIF Grant	Qeveria e Shqipërisë	TOTALI
Punime civile (përf. Kontigj.)	36.87		32.935		69.8
Projektim i hollësishëm & dokumentet e tenderit*			1.215		1.215
Mbikëqyrja e punimeve			1.5		1.5
Mbështetje për zbatimin			1		1
Forcimi i kapaciteteve institucionale		0.87			0.87
Përvetësimi i tokës				1	1
TVSH				15.06	15.06
<b>Totali</b>	<b>36.87</b>	<b>0.87</b>	<b>36.65</b>	<b>16.06</b>	<b>90.45</b>

\*) Ky komponent i projektit ka përfunduar.



**LIGJ**  
**Nr. 30/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR 2011, 2013, 2014, PËR  
PROJEKTIN “PROGRAM PËR  
MENAXHIMIN E MBETJEVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10119, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR 2011, 2013, 2014 PËR  
PROJEKTIN “PROGRAM PËR  
MENAXHIMIN E MBETJEVE”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

Faqe | 4724

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 8 maj 2014, si dhe premtimeve të ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 26 nëntor 2013 (notë verbale nr. 171/2013) dhe të datës 23 nëntor 2011 (notë verbale nr. 197/2011),

kanë rënë dakord si vijon:

**Neni 1**

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose ndonjë huamarrësi/marrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) financimet e mëposhtme:

1) për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve “një hua me kushte të favorshme, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, prej deri në 12 000 000 euro (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës;

2) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit “Program për menaxhimin e mbetjeve” një shumë financimi prej deri në 2 000 000 euro (me fjalë: dy milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur nga pikpamja e politikës zhvillimore;

3) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit “Program për menaxhimin e mbetjeve” një shumë financimi prej deri në 500 000 euro (me fjalë: pesëqind mijë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur nga pikpamja e politikës zhvillimore.

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 pika 1 nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Shumat e financimit të parashikuara në paragrafin



1, pikat 2 dhe 3 mund të përdoren për projekte të tjera po të bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikat 2 dhe 3 do të kthehen hua, nëse ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve dhe të marrësve të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1, pikat 1 dhe 2, do të zhvleftësohet, kur kontratat përkatëse për hua dhe për financim nuk lidhen brenda një afati prej shtatë vjetësh pas vitit të premtimit. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 3, do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për hua dhe për financim nuk lidhen brenda një afati prej tetë vjetësh pas viti të premtimit. Rrjedhimisht, afati për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 1, mbaron më 31 dhjetor 2020. Afati për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 2, mbaron më 31 dhjetor 2021. Afati për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pika 3, mbaron më 31 dhjetor 2019.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve, në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet e mundshme për shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, në të cilën Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbytur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më \_\_\_\_\_, në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë





**LIGJ**  
**Nr. 31/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË**  
**REPUBLIKËS FEDERALE TË**  
**GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM**  
**FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN**  
**“PROGRAM PËR MENAXHIMIN E**  
**MBETJEVE II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10120, datë 7.4.2017,**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË**  
**GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM**  
**FINANCIAR**

**2016**

**PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR**  
**MENAXHIMIN E MBETJEVE II”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë  
dhe

Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partner,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016,

kanë rënë dakord si vijon:

**Neni 1**

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose ndonjë marrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 7 534 862,46 euro (me fjalë: shtatë milionë e pesëqindetridhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy euro, dyzetegjashtë centë), për projektin “Programi për menaxhimin e mbetjeve II” kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur;

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

**Neni 2**

1. Përdorimi i shumës të përmendur në nenin 1, paragraf 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen



dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvleftësohet, kur kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen brenda vitit aktual. Afati për shumën e përmendur mbaron më 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantoj ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë

detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më \_\_\_\_\_, në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës  
së Shqipërisë  
Për Qeverinë e Republikës Federale  
të Gjermanisë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë